



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

VENDIM

Nr. 193, datë 09.04.2024

PËR

**KUALIFIKIMIN E KANDIDATIT {...}
DHE VIJIMIN E PROCEDURËS SË LËVIZJES PARALELE NË
GJYKATËN E SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
TIRANË, PËR POZICIONET E LIRA NË FUSHËN E TË DREJTËS PENALE TË
SHPALLURA ME VENDIMET NR. 80 DHE NR. 81, DATË 20.02.2024, TË KËSHILLIT
TË LARTË GJYQËSOR**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 09.04.2024, pasi u njoh me materialet e çështjes dhe Relacionin “Për gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e tre kritereve ligjore të kandidimit për lëvizjen paralele, të kandidatit z. {...}”, përgatitur nga relatori, si dhe pasi shqyrtoi propozimin për verifikimin e plotësisimit nga kandidati z. {...}, në procedurat për lëvizjen paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionet në fushën e të drejtës penale, të shpallura me Vendimet e Këshillit nr. 80 dhe nr. 81, datë 20.02.2024, të kritereve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”

VËREN

I. PROCEDURA E VERIFIKIMIT

1. Me disa vendime të datës 20.02.2024, Këshilli i Lartë Gjyqësor (*më poshtë referuar si Këshilli*) hapi katërbëdhjetë procedura të lëvizjeve paralele në gjykatat e shkallës së parë, ndër to, me vendimin nr. 80 dhe nr. 81, procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të JP Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale.
2. Afati i kandidimit për këto procedura të lëvizjes paralele si më lart u përcaktua deri më datë 01.03.2024.
3. Brenda afatit të kandidimit për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 80 nr. 81, datë 20.02.2024 (*më poshtë referuar si vendimi 80/2024, dhe 81/2024*), kandidoi edhe z. {...} (*më poshtë referuar si kandidati*), me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të JP Dibër.

4. Pas përfundimit të afatit të kandidimit për procedurat e lëvizjes paralele, mbështetur në pikën 9, të vendimit 80/2024 dhe 81/2024, mbi propozimin e Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, me vendimin nr. 127, datë 11.03.2024, Këshilli miratoi listën e kandidatëve që kanë ose mund të kenë dy vlerësime etike dhe profesionale për efekt të kandidimit në procedurat e shpallura të lëvizjes paralele në gjykatat e shkallës së parë. Në këtë listë është përfshirë dhe z. {...}.
5. Në vijim, me vendimin nr. 140, datë 13.03.2023, Këshilli ka vendosur: *“I. Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Tiranë e Durrës, të shpallura me vendimet nr...80, 81, datë 20.02.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatët që kanë ose mund të kenë 2(dy) vlerësime. II. Caktimin e relatorit për secilin kandidat, si më poshtë: 3. Për kandidatin z. {...} - relator z. Klodian Kurushi; ...”*.
6. Më datë 18.03.2024, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në vendimin e Këshillit nr. 320, datë 17.09.2020, *“Për kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve” (më poshtë referuar si vendimi 320/2020)*, në rrugë elektronike, kandidati u njoftua: i) për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit; ii) për caktimin e relatorit të kësaj procedure verifikimi; iii) për të drejtën që kishte për të kërkuar përjashtimin e relatorit të caktuar dhe/ose të çdo anëtar tjetër të Këshillit, brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e këtij njoftimi.
7. Brenda afatit të përcaktuar, kandidati nuk parashtroi ndonjë pretendim në lidhje me relatorin e caktuar për procedurën e verifikimit ndaj tij apo për ndonjë anëtar tjetër të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
8. Në vijim të procedurës së verifikimit, bazuar në pikën 55, Seksioni C, Kreu V, të vendimit 320/2020, përmes shkresave të veçanta, për kandidatin z. {...} u kërkuar dhe u administruar informacioni i nevojshëm nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, si organi kompetent për krijimin dhe administrimin e dosjeve personale dhe regjistrin të gjyqtarëve, si dhe nga gjykata ku kandidati ka ushtruar funksionin e gjyqtarit.
9. Për verifikimin e kriterëve të *“përvojës profesionale minimale specifike”* dhe atij të *“mospasjes masë disiplinore në fuqi”*, Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, më datë 19.03.2024 përcolli informacionin dhe dokumentacionin përkatës të administruar për kandidatin z. {...}, siç do të përshkruhet më poshtë.
10. Sa i përket kriterit të *“përvojës profesionale minimale specifike”* të kandidatit në fushën e së drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionin e lirë ku ai ka kandiduar, pra në fushën e të drejtës penale, referuar gjykatave ku kandidati ka ushtruar funksionin e gjyqtarit, informacioni u kërkuar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër. Nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër informacioni i kërkuar është përcjell nëpërmjet postës elektronike datë 27.03.2024, siç do të përshkruhet më poshtë.

II. REZULTATET E VERIFIKIMIT TË KRITEREVE TË KANDIDIMIT

A. Për kandidatin z. {...} u verifikua kriteri i “Përvojës profesionale specifike minimale”

11. “Përvoja profesionale specifike minimale” për lëvizjen paralele të gjyqtarit në gjykatën e shkallës së parë, në rastin konkret në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, që gjen reflektim në shkronjën “a”, të pikës 5, të vendimit 80/2024, dhe 81/2024, është parashikuar në pikën 6, të nenit 43, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: *“Magjistrati nuk ka të drejtë të kandidojë në rast se gjatë pesë viteve të fundit nuk ka të paktën një vit përvojë profesionale në fushën përkatëse të së drejtës për pozicionin e lirë ...”*.
12. Për verifikimin e kandidatit në lidhje me plotësimin e këtij kriteri për lëvizjen paralele u mbajt parasysh se ai ka kandiduar për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, çka do të thotë se kandidati duhet të ketë të paktën një vit përvojë profesionale si gjyqtar në fushën e së drejtës penale gjatë pesë viteve të fundit para kandidimit.
13. Në lidhje me përvojën e profesionale, në kërkesën për shprehje interesi dhe në jetëshkrimin e dorëzuar nga kandidati, evidentohet se ka përvojë në seksionin penal. Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjellë nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, kandidati Z. {...}, ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli Jurist, pranë Universitetit të Tiranës në datë 29.03.1994 (kurs i plotë i përsheptuar). Me vendim nr. 13, datë 24.11.1993 të Këshillit të Lartë Drejtësisë emërohet ndihmësgjyqtar efektive pranë Gjykatës së Rrethit Burrel. Me vendim nr. 1, datë 30.03.1995 të Këshillit të Lartë Drejtësisë emërohet gjyqtar dhe Zëvendëskryetar në Gjykatën e Rrethit Mat. Me vendim nr. 229/B, datë 22.04.2008 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë emërohet Kryetar i Gjykatës së Rrethit Gjiqësor Mat, funksion të cilin e ka ushtruar deri në datë 11.10.2013. Me vendim nr. 371, datë 11.10.2013 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë emërohet Kryetar i Gjykatës së Rrethit Gjiqësor Mat. *Me Vendim nr. 5, datë 24.07.2020 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit pezullohet nga detyra për një periudhë 1 vjeçare për të ndjekur programin e trajnimit, sipas kurrikulave të miratuara nga Shkolla e Magjistraturës dhe me Vendim nr. 444, datë 16.09.2021 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit konfirmohet në detyrë.* Me vendim nr. 129, datë 28.03.2023 *“Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër”*, nga data 01.05.2023 transferohet në pozicion të përhershëm si gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, ku dhe aktualisht ushtron funksionin.
Vjetërsia në ushtrimin e funksionit të magjistratit është 30 vite.
Z. {...} nuk ka masa disiplinore në fuqi.
14. Në lidhje me përvojën specifike profesionale në pesë vitet e fundit, sipas informacionit të përcjellë nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, nga verifikimet e kryera, rezulton se për kandidatin: *“Gjyqtari {...} ka filluar të ushtrojë funksionet e gjyqtarit pranë ish Gjykatës së Shkallës së Parë Mat me datën 30.03.1995. Nga data 22.04.2008 – 24.07.2020, ka ushtruar funksionet e Kryetarit të ish- Gjykatës së Rrethit Gjiqësor Mat. Me vendimin e ndërmjetëm të KPK-së, gjyqtari {...} është pezulluar nga detyra për një periudhë*

I vjeçare dhe detyrimin për të ndjekur programin e trajnimit ku me vendimin nr. 444 të KPK-së datë 16.09.2021, është vendosur konfirmimi në detyrë. Nga data 16.09.2021-28.04.2023, ka ushtruar funksionin e kryetarit të ish-Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat. Nga data 02.05.2023 e në vazhdim ushtron detyrën e gjyqtarit pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër.

Në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër për shkak të numrit të vogël të gjyqtarëve (7 gjyqtarë) nuk ka seksione, por gjyqtarët gjykojnë të gjitha çështjet (civile, penale, penale -administrative). Gjithashtu, ish Gjykata e Shkallës së Parë Mat nuk ka pasur seksione për shkak të numrit të vogël të gjyqtarëve (4 gjyqtarë). Në këto rrethana, gjyqtari {...} i ka gjykuar të gjitha llojet e çështjeve (penale/civile / penale –administrative). Në këto kushte, po ju dërgojë statistikën për 5 (pesë) vitet e fundit për gjyqtarin {...}.”

Viti 2023	
Penale	188
Civile	117
Viti 2022	
Penale	122
Civile	135
Viti 2021	
Penale	33
Civile	35
Viti 2020	
Penale	56
Civile	33
Viti 2019	
Penale	148
Civile	133

15. Nga të dhënat që rezultojnë nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, Këshilli vlerëson se kandidati z. {...}, deri në momentin e kandidimit për lëvizjen paralele, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 80 dhe nr. 81, datë 20.02.2024, rezulton të ketë mbi një vit përvojë profesionale specifike minimale si gjyqtar në fushën e së drejtës penale gjatë pesë viteve të fundit përpara kandidimit, duke plotësuar kështu kriterin e “përvojës specifike”.

B. Për kandidatin z. {...} u verifikua edhe kriteri i “mospasjes masë disiplinore në fuqi”.

16. “Mospasja masë disiplinore në fuqi” si kriter ndalues për lëvizjen paralele të gjyqtarit në gjykatën e shkallës së parë, që gjen reflektim në shkronjën “b”, të pikës 5, të vendimit 80/2024, dhe 81/2024, është parashikuar në pikën 6, të nenit 43, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: “Magjistrati nuk ka të drejtë të kandidojë nëse ka në fuqi një masë disiplinore.”

17. Në lidhje me këtë kriter, në rastin e aplikimit, kandidati ka depozituar formularin e Vetëdeklarimit “Për masa disiplinore” datë 01.03.2024, nëpërmjet të cilit, përkundrejt përgjegjësisë ligjore, ka deklaruar se: *“Nuk kam masë disiplinore në fuqi”*.
18. Sipas informacionit të përcjell nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, kandidati z. {...} nuk ka masa disiplinore në fuqi.
19. Nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, nuk vërtetohet që kandidati z. {...} të ketë masë disiplinore në fuqi, duke plotësuar kështu kriterin e “mospasjes masë disiplinore në fuqi”.

C. Për kandidatin z. {...} u verifikua edhe kriteri i “papajtueshmërisë ambientale”.

20. “Papajtueshmëria ambientale” si kriter ndalues për lëvizjen paralele të gjyqtarit në gjykatën e shkallës së parë, që gjen reflektim në shkronjën “c”, të pikës 5, të vendimit 80/2024 dhe 81/2024, është parashikuar në nenin 8, pika 2, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: *“Këshillat, gjatë ... transferimit, ..., për aq sa është e mundur dhe pa cenuar në mënyrë jopropocionale të drejtën për zhvillimin normal të karrierës profesionale të magjistratit, marrin masa për të shmangur papajtueshmërinë ambientale, sipas pikës 3, të këtij neni, me qëllim që të garantohet besimi i publikut në sistemin e drejtësisë, pavarësia dhe paanësia e magjistratit, eficienta e gjykatave dhe zyrave të prokurorisë në dhënien e drejtësisë”*. Ndërkohë, kuptimi i papajtueshmërisë ambientale përcaktohet në pikën 1, të kësaj dispozite ligjore, sipas të cilës: *“Papajtueshmëria ambientale, në kuptimin e këtij neni, krijohet për shkak të lidhjeve të ngushta familjare mes magjistratëve, që janë përkatësisht bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, ose të afërmit e tij deri në shkallë të dytë”*. Sa i takon rasteve të papajtueshmërisë ambientale për sa lidhet me lëvizjen paralele, ato parashikohen në pikën 3, shkronja “a”, të kësaj dispozite ligjore, ku përcaktohet se: *“Papajtueshmëria ambientale përbëjnë rrethanat e mëposhtme: a) nëse respektivisht në të njëjtën gjykatë ose prokurori ku magjistrati kërkon të caktohet, ushtron funksionin një magjistrat tjetër, që ndodhet në kushtet e pikës 1 të këtij neni”*.
21. Në lidhje me papajtueshmërinë ambientale, në rastin e aplikimit, në përputhje me detyrimin sipas nenit 8, pika 5, të Ligjit për Statusin, kandidati ka depozituar formularin e Vetëdeklarimit “Për situatën e papajtueshmërisë ambientale” datë 01.03.2024, nëpërmjet të cilit, përkundrejt përgjegjësisë ligjore, ka deklaruar se: *“Nuk do të ndodhem në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas pikës 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”*.
22. Gjatë verifikimit nuk rezultoi ndonjë e dhënë e ndryshme nga ajo e deklaruar nga kandidati në lidhje me situatën e papajtueshmërisë ambientale për sa ai kandidon për lëvizjen paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
23. Nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, për kandidatin z. {...} nuk vërtetohet të ndodhet në situatën e papajtueshmërisë ambientale në rast të transferimit nëpërmjet lëvizjes paralele në gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, duke plotësuar kështu kriterin e “papajtueshmërisë ambientale”.

III. KONKLUZIONE

24. Referuar kërkesave të Vendimit 320/2020, duke mbajtur parasysh edhe përcaktimet e Vendimeve të Këshillit nr. 80 dhe nr. 81 datë 20.02.2024, nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar gjatë procedurës së verifikimit paraprak të tre kritereve formale të kandidimit të z. {...} për lëvizjen paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionet në fushën e të drejtës penale, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se procedura e verifikimit e ndjekur në këtë rast është e plotë dhe në përputhje me ligjin.
25. Bazuar në sa më lart është parashtruar mbi rezultatet e verifikimit paraprak të tre kritereve formale të kandidimit për kandidatin z. {...}, konkretisht të kritereve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se kandidati i plotëson ato, ndërsa nuk ekziston ndonjë shkak për skualifikimin e tij nga kandidimi në lidhje me këto kritere. Nisur nga kjo, Këshilli çmon se është vendi për verifikimin e plotësimin nga kandidati z. {...}, në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, të tre kritereve të sipërpërmendura të kandidimit për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimet nr. 80 dhe nr. 81 datë 20.02.2024.

PËR KËTO ARSYE

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 8 dhe në pikën 6, të nenit 43, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në vendimin e tij nr. 320, datë 17.09.2020, “Për kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve”, si dhe në pikën 10, të vendimit të tij nr. 80 dhe nr. 81, datë 20.02.2024, “Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së parë të juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale”, pasi shqyrtoi materialet e çështjes dhe relacionin e përgatitur nga relatori, z. Klodian Kurushi,

VENDOSI:

1. Kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 80 dhe nr. 81 datë 20.02.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR